



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT Arkivi Qendror - Centralno Arhivo - Central Archive
Nr./Br./No. 3330
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 3
Pratje/Attachment: 10.08.2023
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 08.08.2023
Ref. KM-296/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

VENDIM

Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve –Triscabol DG i prodhuesit UPL Europe Ltd,UK nga përfaqësuesi i saj Eco Tech-Pest Control SH.P.K, Suhareke.

2. LLOJI I PRODUKTIT: Fungicide

3. PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE: Ziram.....760gr/kg

4. PËRDORIMI:

Triscabol DG është fungicid kontakti me veprim parambrojtës në luftimin e sëmundjeve të ndryshme kërpudhorë, në perime si kalbëzimi dhe antraknozave të domates etj, e pemëve si: Gjethepërdredhëses dhe gjethë birueses në pjeshke e bërthamore të tjera, kromës në molle e dardhe dhe antraknozave, septoriozave, alternariozave, ndryshmëve në kultura të ndryshme.

Në Bërthamore :(pjeshke, kajsi, kumbull, qershi etj.).Në trajtimet dimërorë në pjeshke me fillim të rënjës së gjethëve 400g/ujë, bërthamoret e tjera me fillim të fryrjes së sythave, në trajtimin pranveror-veror në luftimin e (Tafrinia deformans), gjethë birueses (Stigmina carpophilla) me doza 400gr/100 lit/ujë trajtimet përsëriten deri në butonat e kuq dhe pas lulëzimit me doze 250g/100lit/ujë.

Ne Farore: (mollë, dardhë etj.) kundër kromës (*Venturia inequalis*, *Venturia pirina*), septoriozes (*Septoria spp*), në periudhën e veshit të miut e deri të para lulëzimit me doze 250/100lit/ujë, dhe pas lulëzimit 300g/100lit/ujë.

Ne Perime: Domate luftimin e septoriozes (*Septoria lyopersici*) alternaries (*Alternaria spp*), antraknozave (*Colletotrichium phomides*), bakteriozave (*Pseudomonas spp*, *Xanthomonas vesicatoria*), lakër luftimin (*Alternaria brassicae*), sallate, karotë, qepe, hudhra, presh në luftimin e (*Alternaria spp*) dhe ndryshkut 250g/100lit/ujë.

5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:

1kg, 5kg, 10kg, 15kg dhe 20 kg

6. KARENCA:

Lakër, karota 14 dite, lulëlakër 21 dite, sallate 14 dite, sallate 14 dite, qepë 28 dite, peme farore e bërthamore 28 dite.

7. VËREJTJE:

Normat e sasisë së ujërave lëvizin 200-2000 litra duke u mbështetur nga stadi i vegjetacionit. Nuk përzihet me produktet që kanë hekur, merkur, bakër, kalcium.



GHS05-paralajmërim për rrezikun-ndryshku

8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:



GHS06-helmues



GHS09- paralajmërim i rrezikshëm për ambient.



GHS08- i dëmshëm për shëndetin

9. VENDI I SHITJËS: Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

10. Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar në Databazën e Pesticideve të BE-se/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Faton Peci



Vendimi i dërgohet:

- *Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;*
- *Shërbimi kufitar fitosanitar;*
- *Inspektorët fitosanitar AUV;;*
- *Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Arkivit.*